



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SLLAVO-BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Laborator teknik dhe praktike

Ngarkesa: 30 Seminare, 30 Leksione, 6 Kredite
Viti / Semestri: Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master Shkencor Mësuesi /Gjuhë Turke
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo lëndë synon: Njohjen e studentëve me parimet e përgjithshme të shkrimit të një punimi masteri. Aftësimin e studentëve për të ndjekur me kujdes të gjitha hapat e nevojshëm gjatë shkrimit të punimit. Njohjen e studentëve me strukturat e ndryshme të ndërtimit të një punimi masteri. Njohjen e studentëve dhe aftësimin e tyre për shkrimin e kapitujve të veçantë të punimit të masterit. Njohjen e studentëve me rregullat mekanike të shkrimit të punimit të masterit. Njohjen e studentëve me mënyrat e ndryshme të citimit apo edhe përdorimin e parafrazimit apo përmbledhjes. Aftësimin e studentëve për të shkruajné një punim masteri, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet e vendosura.

Objektivat specifike lëndore:

1. Në këtë lëndë studentët përtej njohurive akademike të tyre në mësimdhënien e turqishtes si gjuhë të huaj,
2. Do të njihen me metodologjinë e inxhinierisë së formimit, me tipologjinë e teksteve dhe terminologjinë e fushave specifike

Rezultatet e pritshme:

1. Zhvillojë mendim analitik, kritik dhe kreativ, duke interpretuar me argument dhe logjikë materiale të ndryshme studimore.
2. Realizojë studime të pavarura dhe në terren, përmes përdorimit të metodave kërkimore si pyetësorë, intervista dhe analiza e burimeve të dorës së parë dhe të dytë.
3. Përdorë me kompetencë burime bibliografike shkencore, si dhe të ndërmarrë studime të mëtejshme në mënyrë autonome, me bazë të qëndrueshme akademike.